

URDHËR
Nr. 72, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003; “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin e organit të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me parashikimet në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo.

2. Në ushtrimin e kompetencës së deleguar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z. Erlind Sulo, ndjek dhe zbaton rregullat dhe procedurat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Urdhri nr. 39, datë 2.2.2026, i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi